

Specialist në Sektorin e GIS-it Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

Specialist në Sektorin e GIS-it Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

(Detyrat kryesore paraqiten si rezultat i punës së kryer)

- a) Asiston dhe kontrollon të gjitha punimet që lidhen me ndërtimin, mirëmbajtjen, aksesimin dhe funksionimin e GIS-it Kombëtar.
- b) Merr pjesë në përgatitjen dhe implementimin e standardeve mbi platformën dhe arkitekturën sipas së cilës do të funksionojë GIS-i Kombëtar duke pasur në konsideratë zhvillimet ndërkombëtare në këtë fushë.
- c) Kryen integrimin në GIS-in Kombëtar të sistemeve të reja GIS të ndërtuara nga autoritetet e tjera publike për temat që parashikohen në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012.
- d) Mban të përditësuar bazën e të dhënave të GIS-it Kombëtar dhe monitoron funksionimin e tij.
- e) Administron informacionin gjeohapësinor që është pjesë e GIS-it Kombëtar, nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar.
- f) Bën vlerësimin paraprak të nismave që paraqesin autoritetet publike pranë ASIG për ndërtimin e sistemeve GIS me temat e parashikuara në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012.
- g) Organizon mbrojtjen e informacionit që përmban GIS-i Kombëtar, nga çdo lloj aksesi i pa autorizuar.
- h) Asiston dhe kontrollon institucione të tjera, në bazë të urdhrit të Eprorit Direkt, në ndërtimin e sistemeve GIS duke i’ u përmbajtur kuadrit ligjor në fuqi dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij kuadri ligjor.
- i) Asiston dhe kontrollon, me urdhër të Eprorit Direkt, institucionet përgjegjëse në krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e metadatave të të dhënave gjeohapësinore në bazë të ligjit nr. 72/2012.

DETYRAT TEKNIKE

- a. Siguron përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit sipas rëndësisë dhe Drejtorin e Drejtorisë lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë punës së tij.
- b. Përgatit sipas udhëzimeve të Eprorit Direkt dokumenta teknike në bazë të detyrave kryesore.
- c. Ndjek dhe mbështet stafet teknike të autoriteteve publike në kuadër të ngritjes dhe mirëmbajtjes së sistemit të GIS-it Kombëtar.
- d. Siguron kontrollin teknik të temave të gjeoinformacionit dhe shërbimeve të rrjetit për tu bërë pjesë e GIS- it Kombëtar.
- e. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin.
- f. Përfaqëson institucionin vetëm në rastet me propozim të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

(Arsim/ përvoja në punë/ të tjera për kategorinë/ klasën/ grupin)

Arsimi: Diplomë "Master profesional" në Gjeodezi/ Gjeoinformatikë

Përvoja: Të ketë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse.

Tjetër:

- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.
- Aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale.
- Aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale.
- Aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.
- Aftësi të mira komunikimi, propozim dhe menaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi.
- Aftësi për të punuar në grup.
- Të njohë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor dhe komunikimit elektronik.
- Të ketë eksperiencë në organizimin e seminareve/workshop- eve në sektorin që mbulon ASIG.
- Të njohë kërkesat e legjislacionit të BE- ë që lidhen me gjeoinformacionin në kuadrin e integritetit të vendit në BE.
- Të ketë eksperiencë në administrimin e sistemeve GIS dhe WEBGIS.

- Të njohë platformat e avancuara Quantum Gis, ArcGIS Desktop, ArcGIS Server, PostgresSQL, PostGIS, Openlayers, Mapserver, Geoserver, Geonetwork, Hale Data Harmonization.
- Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 18.09.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.